

KPK shkarkon nga detyra gjyqtaren që votoi kundër heqjes së burgimit të përjetshëm për Dajtin

Nga Exit News



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shkarkoi të enjten nga detyra gjyqtaren e Apelit Shkodër, Lindita Hoxha.

Vendimi u dha nga Etleda Çiftja, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine.

ILDKPI-ja hartoi një raport negative për gjyqtaren për deklaram të pasaktë, mungesë të dokumentacionit ligjor për të ardhurat e bashkëshortit.

Komisioni gjeti se në lidhje me një apartament të blerë në 2002 me çmimin 2 milionë lekë, gjyqtarja Hoxha nuk ka deklaruar një hua në vlerën 1 milion lekë si dhe Komisioni ngriti dyshime se Hoxha mund ta ketë blerë me një vlerë tregu më të ulët.

Gjithashtu u evidnetua mosdeklarimi i pakësimit të gjendjes cash në vitin 2006, kur është kryer blerja e apartamentit.

Sipas KPK-së Hoxha ka rezultuar me pamundësi financiare në shumën 313 mijë lekë për pagesën e këstit të dytë për një apartament me sipërfaqe 56.5 m² të blerë në vitin 2016 në Shëngjin të Lezhës në vlerën 35 mijë e 400 euro.

Për një apartament tjetër që bashkëshorti e ka blerë para martesë, në vitin 2001, në shumën 500 mijë lekë, KPK konstaton pamundësi për të provuar të ardhurat e përfituara prej tij.

Sipas Komisionit gjyqtarja Hoxha nuk ka deklaruar në vitin 2005 blerjen e një autoveture tip Benz në vlerën 250 mijë lekë si dhe për automjet tip Benz të blerë në vitin 2010 në shumën 5000 euro u gjetën mospërputhje për burimin e krijimit, pasi ndryshe nga deklaramta periodike ku janë shënuar kursimet familjare si burim, në atë veting është pasqyruar edhe një hua.



Nga analiza financiare për periudhën 2003-2016 ka rezultuar një balancë negative në vlerën 548 mijë lekë.

Në lidhje me figurën dhe profesionalitetin gjyqtarja Hoxha u vlerësua pozitivisht.

Gjyqtarja ka një karrierë 27-vjeçare në sistemin e drejtësisë. Prej vitit 2003 ajo ka shërbyer si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër. Në vitin e 2019, Hoxha ishte një nga 5 gjyqtarët e Apelit që shqyrtuan çështjen e uljes së masës së dënimit ndaj Dritan Dajtit, i cili vrau 4 policë.

Hoxha së bashku me ish-kreun e Apelit Shkodër, Fuat Vjerdha ishin kundër heqjes së burgimit përjetshëm për Dritan Dajtin.